

# MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

## NDËRMJET

MINISTRISË SË INTEGRIMIT EVROPIAN TË REPUBLIKËS SË SHQIPERISË

## DHE

MINISTRISË SË INTEGRIMIT EUROPIAN TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TEKNIK PËR PËRKTHIMIN E LEGJISLACIONIT  
TE BE-SË NË GJUHËN SHQIPE, SI DHE BASHKËPUNIMIT NE SFERËN E  
PËRAFRIMIT TE LEGJISLACIONIT

Ministria e Integrimit Evropian e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Integrimit Evropian e Republikës së Kosovës, (më tutje, Palët), duke shprehur vullnetin për nxitjen e zhvillimit të marrëdhënieve dypalëshe në fushën e Integrimit Evropian,

Duke qenë të bindur se ngritja e nivelit të bashkëpunimit do të ndikojë në përmirësimin e efikasitetit të dy strukturave me qëllim të përshpejtimit të procesit të integrimit Evropian të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës,

Në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Integrimit Evropian të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Integrimit Evropian të Republikës së Kosovës e vitit 2010;

Të vetëdijshëm që mbledhjet e përbashkëta të Qeverive do të forcojnë bashkëpunimin dypalësh në të gjitha fushat;

Në përmbushje të interesave të përbashkëta, palët bien dakord si më poshtë:

### **Neni 1 Krijimi**

Palët do të krijojnë Komisionin Teknik për koordinimin e përkthimit të Legjislacionit të Bashkimit Evropian – “Acquis” në gjuhën shqipe dhe bashkëpunimin në sferën e përafrimit të legjislacionit.

### **Neni 2 Përbërja**

1. Komisioni Teknik përbëhet nga 3 anëtarë të përhershëm të secilës palë;
2. Anëtarët e përhershëm emërohen me vendim nga institucionet përkatëse të secilës palë;

3. Komisioni Teknik për plotësimin e nevojave të punës fton në takim ekspertë të tjerë të fushës;
4. Kryesimin e Komisionit Teknik e ushtron pala organizatore e takimit.

### **Neni 3 Kompetencat**

1. Komisioni Teknik përcakton dhe koordinon Kalendarin vjetor të legjislacionit të BE-së që duhet të përkthehet në gjuhën shqipe nga secila palë;
2. Komisioni teknik përcakton procedurat e unifikuara të përkthimit dhe verifikimit të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe nga palët;
3. Komisioni Teknik çertifikon versionet finale të akteve të përkthyera në gjuhën shqipe;

### **Neni 4 Procedura e Punës**

1. Komisioni Teknik harton dhe miraton Rregulloren e Punës;
2. Plani vjetor i punës miratohet në mbledhjen e parë të çdo viti kalendarik;
3. Mbledhjet e Komisionit Teknik mbahen çdo tre muaj;
4. Vendimet në Komisionin Teknik merren me unanimitet.

### **Neni 5 Shkëmbimi reciprok**

1. Palët pajtohen në shkëmbimin e përkohshëm të stafit dhe të përvojave me qëllim të përmirësimit, të përmbushjes dhe shtimit të efikasitetit të punës nga ana e dy institucioneve të përfshira me këtë marrëveshje;
2. Palët pajtohen që shkëmbimin e materialeve të përkthyera ta vendosin në një databazë elektronike të përbashkët.

### **Neni 6 Ndryshimi**

1. Marrëveshja mund të ndryshohet në çdo kohë përmes një marrëveshje me shkrim në mes të palëve;
2. Marrëveshja mund të përfundojë në menyrë të njëanshme nga secila palë pas paraqitjes me shkrim të njoftimit përkatës nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e Marrëveshjes. Përfundimi i Marrëveshjes hyn në fuqi me konfirmimin e marrjes së notës nga pala tjetër.

**Neni 7**  
**Hyrja në Fuqi**

1. Marrëveshja hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dy palët dhe vlen për një periudhë të pacaktuar kohore.

Nënshkruar në Prishtinë, më **26/03/2014** në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe angleze.

Në rast mosmarrëveshjesh në interpretim mbizotëron teksti në gjuhën shqipe.

**Klajda GJOSHA**  
**Ministre e Integrimit Evropian e**  
**Republikës së Shqipërisë**



**Vlora ÇITAKU**  
**Ministre e Integrimit Evropian e**  
**Republikës së Kosovës**

